



## Problemet e edukimit dhe shkolla

Aida Kaciqi

### Abstract

This scientific work addresses the problems of education and the role of the school in educational work. This article also addresses even some thoughts of foreign and albanian philosophers and pedagogues about the problems of education in different historical periods. The attention is focused on methods and means of education, even at the role of educators and the family in the education process.

**Key words:** education, school, educator, family, educational environment, education model.

### Abstrakt

Në këtë punim shkencor trajtohen problemet e edukimit dhe roli i shkollës në punën edukative. Ky artikull trajton edhe disa mendime të filozofëve e pedagogëve të huaj e shqiptarë për problemet e edukimit në periudha të ndryshme historike. Vëmendja përqendrohet te metodat dhe mjetet e edukimit, tek roli i edukatorëve dhe i familjes në procesin e edukimit.

**Fjalë kyç:** edukim, shkollë, edukator, familje, mjedis edukues, model edukimi.

\* \* \*

Procesi i edukimit është përkufizuar si përcjellja brez pas brezi e përvojës së shoqërisë në të gjitha fushat. Tek njeriu edukimi është një veprimtari e vetëdijshme, e qëllimshme, e planifikuar, e organizuar, sistematike dhe e vazhdueshme. Edukimi është një dukuri njerëzore. Si i tillë, ai është i pandarë nga shoqëria në të cilën zhvillohet. I gjithë edukimi në Spartë bazohej në përgatitjen e organizuar dhe absolute ushtarake sipas dekretëve të Likurgut. Në Athinë për edukimin fillestar që ishte privat, ekzistonin shkolla inferiore të quajtura Didaskalitë ose Mësimtore. Nuk ekzistonte ndonjë dekret i shtetit që të modifikonte programet e mësimdhënies, pasi ato bazoheshin tek traditat. Qëllimi i këtyre programeve ishte shpalosja harmonike e moralit të fëmijës. Rolin kryesor e kryente leximi dhe mësimi përmendsh i poezive dhe miteve. Platoni theksonte se fëmijët duhet të edukohen me

mitet, muzikën dhe gjimnastikën e përshtatshme, në mënyrë që të zhvillojnë të gjitha virtytet e tyre si: të trimërisë, guximit, prurcencës dhe ndjenjës së drejtësisë. Gjimnastika, nënvizonte ai, ka një rol të madh edukues në lidhje me trupin, të cilin duhet ta forcojë dhe ta drejtojë drejt trimërisë. Në moshën 3-6 vjeç, theksonte Platoni, fëmijët kanë nevojë për argëtim dhe lojëra, por është edhe momenti të mësojnë rregulla sjelljeje, një disiplinë fillestare. Ai kërkonte edhe arsim për vajza<sup>1</sup>.

Edukimi dhe arsimimi i individit në shoqëritë e lashta nuk përbente një rast të izoluar të jetës së fëmijës, por gjendje që zgjat gjithë jetën. Ai fillon që nga lindja dhe mbaron me vdekjen. Edukimi vlerësohej si një procedurë që nuk mbaron kurrë duke aktivizuar të gjitha mundësitë shpirtërore, mendore, psikologjike dhe natyrore. Aristoteli, filozofi më i shquar dhe mendimtari më i madh i kohës së lashtë, theksonte se individi është pjesë e shtetit, prandaj shkolla duhet të jetë shtetërore. Aristoteli konsiderohet nga historia e pedagogjisë si i pari që bëri ndarjen e moshës shkollore në tri periudha.<sup>2</sup>

E para mbaron në moshën 7 vjeç, e dyta që fillon nga kjo moshë, mbyllet me pjekurinë seksuale, kurse e treta nga pjekuria seksuale deri në moshën 21 vjeç. Ai themeloi liceun. Këtu ai synonte në harmonizimin e zhvillimit fizik, moral dhe mendor të fëmijëve.

Pedagogu i shquar demokrat zviceran, Johan Heinrich Pestaloci (1746-1827), një nga themeluesit e didaktikës së arsimit fillor, theksonte se qëllimi kryesor i edukatës është zhvillimi i aftësive natyrore, formimi i njeriut me cilësi të larta morale. Çdo njeri, sipas tij, duhet ta ndiejë veten si një pjesëtar të njerëzimit dhe jo si një njeri të vetmuar.<sup>3</sup> Edukimin fizik e konceptoi në kuadrin e trinomit "Pedagogjia e kokës, e zemrës, e dorës".

Pedagogu i shquar dhe mendimtari humanist çek Jan Amos Komenski, formuloi një sistem arsimor me karakter unik nga shkolla e ulët deri tek e larta, duke e ndarë në etapa: 0-6 (shkolla e nënës), 6-12 (shkolla amëtare), 12-16 (gjimnazi) dhe 18-24 (akademia ose universiteti).<sup>4</sup> Me emrin e tij lidhen parimet e të mësuarit: nga e lehta tek e vështira, nga e afërmja tek e largëta, nga e përgjithshmeja tek e veçanta, nga konkretja tek abstraktja.

<sup>1</sup> Shefik Osmani, Fjalori i pedagogjisë, Tiranë, 1983, faqe 538.

<sup>2</sup> Po aty, faqe 37.

<sup>3</sup> Po aty, faqe 519-520.

<sup>4</sup> Po aty, faqe 313.



Ai argumentoi nevojën e arsimit parashkollor dhe kërkoi arsim pa dallim shtrese dhe seksi.

Pedagogu i shquar rus i shekullit XIX , Konstantin Dimitrievič Ushinski, shtroi me të madhe parimin popullor të edukatës si dhe rolin e gjuhës amtare, e cila duhet të zërë vendin kryesor në shkollën e ndërtuar mbi bazën e parimit popullor. Në veprën e tij "Njeriu si objekt i edukatës", ai formuloi disa nga parimet didaktike të procesit mësimor: përvetësimi i ndërgjegjshëm i njohurive, të mësuarit sistematik dhe të vazhdueshëm, konkretizimi i mësimit dhe të mësuarit e qëndrueshëm. Ai trajtoi gjerësisht problemet e edukatës morale dhe sidomos ato të edukimit atdhetar dhe të edukatës së punës. Lidhur me këto ai i jep rëndësi të madhe shembullit personal të mësuesit dhe metodës së bindjes. Anton Semionoviç Makarenko(1888-1939), pedagog i shquar rus(ukrainas)ji periudhës pas Revolucionit të Tetorit , përpunoi thellë problemet e edukimit në familje, çështje të figurës morale dhe të rolit të mësuesit si dhe një varg problemesh të tjera. <sup>5</sup> Ai synonte në edukimin e nxënësve me dashurinë e pakufishme ndaj atdheut, në edukimin në kolektiv, në edukimin e ndjenjës së detyrës, të ndershmërisë dhe disiplinës. Ai udhëhoq nga parimi: edukimi në kolektiv, nëpërmjet kolektivit dhe për kolektivin. <sup>6</sup>Makarenko luajti rolin e pararendësit me idenë e tij të fëmijëve që studiojnë gjatë procesit që edukohen, një proces që përfshin shndërrimin aktiv të udhës së tyre të jetës dhe që ndikon në ndërgjegjen, ndjenjat dhe sjelljet e tyre.

Lev Semioviç Vigotski(1896-1934) nga Biellorusia , një nga psikologët më të mëdhenj të shekullit XX, i ka kushtuar rëndësi të veçantë ndërvëprimit shoqëror në procesin e edukimit. Në vitin 1932 ai ka shkruar: "Fëmija ndërmerr veprimtari nëpërmjet mendimit të të tjerëve, nëpërmjet mendimit të të rriturve. Në mënyrë absolute gjithçka në sjelljen e fëmijës i ka rrënjët në marrëdhëniet shoqërore dhe shkrihet brenda këtyre marrëdhënieve shoqërore. <sup>7</sup> Pedagogu i shquar, filozofi dhe moralisti gjerman Johan Fridrih Herbart, në vitin 1806 shkroi veprën "Pedagogjia e përgjithshme përmes qëllimeve të edukimit",ku pasqyroi vëzhgimet dhe përfundimet e eksperimenteve të tij. Në formë më të qartë e më të kuptueshme këto arritje i botoi në vitin 1835 nën titullin "Koncepte pedagogjike". Virtyti, thotë ai, është qëllimi më i lartë i edukatës. Ai theksonte se qëllimet e edukimit burojnë nga interesat. Duke pranuar ndëshkimet fizike, sistemi pedagogjik i tij edukon pasivitetin e nxënësit, mbyt mendimin krijues dhe edukon qytetarë të bindur verbërisht, të nënshtruar, formalë.

Edhe pikëpamjet dhe idetë e filozofit anglez Xhon Lock zënë një vend të rëndësishëm në historinë e pedagogjisë. Kryesisht për shkrimin e tij "Mendime mbi edukimin",ky konsiderohet si një teoricien i brendshëm i edukimit. Në planin pedagogjik ai i kushton rëndësi zhvillimit të

<sup>5</sup> Po aty, faqe 402.

<sup>6</sup>G. N. Filnov, Anton Makarenko, në: Mendimtarët për edukimin, botim i Byrosë Ndërkombëtare të Edukimit, UNESCO, Plejad, 2008, përktheu Jonisa Angoni, faqe 301.

<sup>7</sup> Ivan Iliç, Lev. S. Vigotski, në: Mendimtarët për edukimin, botim i Byrosë Ndërkombëtare të Edukimit, Unesco, Plejad, 2008, faqe 359, përktheu Jonisa Angoni, faqe 359.

proceseve psikologjike të fëmijës dhe impulseve instiktive të tij. Fëmija, sipas tij, do të edukohet me forcë dhe me vonë me dashamirësi, mirëkuptim dhe miqësi. Xhon Lock theksonte se roli i mjedisit në formimin e personalitetit është mjaft i madh.

Pedagogu gjerman Fridrih Frobel ishte përfaqësues i romantizmit pedagogjik. Ai themeloi një institut edukativ të nivelit të dytë dhe në vitin 1839-1840 hapi kopshtin e parë për fëmijë. Ai u është përkushtuar për një kohë të gjatë reformave edukative dhe organizimit të formimit të edukatorëve. Sipas tij, edukuesi duhet të bëjë universale individualen dhe të veçantën dhe anasjelltas, universalen të veçantë e individuale dhe t'i demonstrojë të dyja.

Zhan Zhak Ruso, iluminist francez i shekullit XVIII, filozof, shkrimtar dhe pedagog i shquar, i kushtoi rëndësi edukimit në natyrë dhe në përshtatje me natyrën. Lidhur me këtë, ai përcakton burimet e edukatës: nëpërmjet natyrës, nëpërmjet sendeve dhe rrethanave dhe nëpërmjet njerëzve. <sup>8</sup> Në librin e tij "Emili ose mbi edukatën"jep mësimin e tij pedagogjik. Sipas Rusoit , fëmija do të edukohej në kontakt të ngushtë me natyrën dhe vetë natyra do të jetë libri i fëmijës.

Edhe filozofi gjerman Emanuel Kant ka dhënë mjaft mendime për edukimin. Në leksionet e tij pedagogjike që janë mbledhur dhe publikuar nga nxënësit e tij, ai rekomandon edukimin e mendimit të lirë dhe formimin e autonomisë morale.

Mjaft me interes është mendimi pedagogjik i mendimtarit gjerman të shekullit XIX, Distervegu. Ai ka shkruar 50 vepra pedagogjike. Sipas tij, njeriu duhet të edukohet me dashuri ndaj njerëzimit dhe dashuria ndaj njerëzimit dhe atdheut duhet të shkojë krahas. Sistemi i tij pedagogjik mbështetet në tri parime themelore: vetaktiviteti , edukimi në harmoni me natyrën dhe edukimi në harmoni me kulturën. Parimet dhe rregullat didaktike të tij janë aktuale dhe sot: parimi i përshtatjes së mësimit sipas aftësive individuale, parimi i konkretizimit të mësimit, parimi vetaktivitetit të nxënësit në mësim, parimi i gradualitetit, parimi i sistematizimit, parimi i qëndrueshërisë së njohurive.

Jean Piaget (1896-1980), psikologu më i famshëm i shekullit XX, për më shumë se një gjysmë shekulli vëzhgoi dhe studioi veprimtarinë e fëmijëve në disa drejtime. Zhvillimi njohës tek fëmijët, theksonte ai, bëhet nëpërmjet bashkëveprimit të tij me mjedisin rrethues. Piaget, duke shkruar për pedagogjinë moderne, ka theksuar se pedagogjia është si mjekësia: një art, por që mbështetet ose duhet të mbështetet në njohuri shkencore të sakta.....

Mund të jesh edhe edukator deri në palcë dhe megjithatë të duhet të njohësh jo vetëm degët në të cilat jep mësim, por edhe vetë fëmijën ose adoleshentin, të cilit i drejtohesh: shkurt, nxënësi si qenie njerëzore, transformohet dhe zhvillohet mendërisht sipas ligjeve po aq komplekse sa organizmi fizik. <sup>9</sup>

Piaget shtron problemin e edukimit duke u nisur nga metodat. Ai është për shkollën e re që sjell risi duke future metoda të reja, metodat e shkollës aktive. Ato theksojnë rëndësinë e parimeve të lirisë, veprimtarisë

<sup>8</sup> Po aty, faqe 607.

<sup>9</sup> Jean Piaget, IKS, Mbi pedagogjinë, Tiranë ,2005, faqe 165.



dhe interesit të fëmijës me synimin që të favorizohet zhvillimi i tij i natyrshëm.

Pedagogu , psikologu dhe filozofi idealist amerikan Xhon Djui shkruante se edukata për jetën sociale do të thotë ushqimi dhe shumimi për jetën fiziologjike.

Shumë filozofë dhe pedagogë në kohë të ndryshme kanë theksuar rolin e nënës në edukimin e fëmijëve. Platoni thoshte se deri në moshën 6-vjeçare fëmija duhet të jetojë në shtëpi, afër nënës ose dados, nga të cilat merr edhe mësimet e para për jetën. Edukimi, sipas tij, fillon që nga momenti i shtatzanisë dhe varet nga jeta dhe përjetimet e nënës gjatë kësaj periudhe. Dadot e fëmijëve dhe nënat, nënvizonte Platoni, këshillohen që mitet t'ua thonë fëmijëve në mënyrë që të fillojnë me to shpirtrat e tyre, gjë që është shumë më e rëndësishme sesa ndërtimi i trupave.

Johan Heinrich Pestaloci e vlerësonte shumë edukatën familjare dhe në mënyrë të veçantë rolin e nënës.

Edhe vëllezërit rilindës Naim dhe Sami Frashëri i jepnin shumë rëndësi rolit të gruas (nënës) në edukimin e fëmijës. Sipas Naimit "Gruaja duhet të jetë e mësuar më shumë nga burri ,se fëmija së pari nga mëma e marrë në arsiminë dhe mësimetë. Druri posi të rritet, më s'kthehet".<sup>10</sup>

Sami Frashëri theksonte se në edukatën e punës ndikon shumë shembulli i prindit dhe imitimi i sjelljeve dhe i punëve të nënës: "Kalamani, qysh prej një viti e deri në 8 vjeç nuk shkoqet nga e ëma...çdo lëvizje, çdo sjellje të nënës ai ka për ta imituar."<sup>11</sup>

Edukimi, pra, është dukuri historike dhe shoqërore. Ai është një hallkë e një zinxhiri që i lidh gjeneratat dhe mundëson që secila gjeneratë të vazhdojë veprat e paraardhësve të vet duke dhënë kështu ndihmesë në përsosjen e kulturës së njeriut. Edukimi është i orientuar kryesisht në formimin e personalitetit dhe të karakterit, në formimin e atyre tipareve nga të cilat çmojmë dhe synojmë të formojmë personalitetin.<sup>12</sup>

Me edukim kuptojmë procesin e formimit të pikëpamjeve, të qëndrimeve dhe të sjelljeve, të botëkuptimit shkencor, të qëndrimeve dhe marrëdhënieve etiko-shoqërore, të njohjes morale, të kuptuarit dhe bindjeve, të sjelljeve dhe të veprimeve morale, të qëndrimit pozitiv ndaj njerëzve dhe bashkësisë së gjerë, ndaj punës, pronës, atdheut dhe vetvetes, të veçorive pozitive të vullnetit, të ndjenjave fisnike të një karakteri të fortë pozitiv .<sup>13</sup>

Shkolla dhe mësuesit gjatë veprimtarisë së përditshme mësimore-edukative duhet të respektojnë disa nga parimet e edukimit. Këto parime janë: pikësynimi i qartë edukativ, mbështetja në vlerat kombëtare, lidhja e edukimit me jetën, karakteri aktiv i edukimit, edukimi në grup, mbështetja në pozitiven dhe në suksesin e arritur, kombinimi i udhëheqjes pedagogjike me vetëveprimin e fëmijëve, uniteti i kërkesave në punën edukative, marrja parasysh e moshës dhe e veçorive individuale të fëmijëve dhe familjeve. Bashkërendimi i kërkesave të

punës edukative nga të gjithë edukatorët që punojnë me të njëjtat kontigjente fëmijësh a të rinjsh është i domosdoshëm për arritjen e suksesit në çdo institucion edukativ. Drejtoria e shkolles, mësuesit e lëndëve të ndryshme, mësuesit kujdestarë të klasave, psikologët e shkollave dhe qeveritë e nxënësve duhet të harmonizojnë kërkesat duke u mbështetur në synimin e përbashkët të shkollës bashkëkohore. Ata duhet të krijojnë një front unik të punës edukative dhe jo "njëri t'i bjerë gozhdës e tjetri patkoit." Edhe marrja parasysh e moshës dhe e veçorive individuale të fëmijëve kërkon që, krahas punës në grup, në kolektiv, me gjithë klasën, të merret parasysh edhe puna e diferencuar me nxënës, fëmijë a të rinj të veçantë. Mësuesi, edukatori bashkëkohor duhet të jetë udhëheqës i procesit të edukimit, motivues e partner në komunikimin e veprimtaritë edukative me të gjithë klasën, por edhe me nxënës të veçantë sipas veçorive individuale e temperamentit që kanë. Edukatori i mirë futet me takt në botën e brendshme të çdo nxënësi duke kryer detyrën e këshilltarit, lehtësuesit , ekspertit, mbrojtësit të të drejtave dhe lirive të tij dhe të moderatorit që ndihmon si përballohen sfidat, si zgjidhen mosmarrëveshjet e si mënjanoen konfliktet që janë të shumta në moshën e adoleshencës dhe të paraadoleshencës. Puna e kujdesshme dhe profesionale e individuale me këto moshë bën që të mënjanoen zënkat, meritë dhe fyerjet gjatë veprimtarive edukative në bazë klase e shkolle. Në këtë mënyrë, duke kombinuar punën edhe me qeveritë e nxënësve , zhvillohet ndjenja e bashkëpunimit, mirëkuptimit dhe tolerancës. Me një punë sistematike dhe të diferencuar me fëmijë dhe të rinj që vijnë nga familje me mentalitete të ndryshme, arrihet që të forcohet ndjenja e ndihmës reciproke dhe njerëzore për bashkëmoshatarët dhe të rriturit.

Çdo njeri në jetën e tij të përditshme realizon disa role shoqërore .<sup>14</sup>

Tërësia e këtyre roleve dhe mënyra sesi realizohet cdo rol përbëjnë individualitetin e secilit dhe njëkohësisht realizojnë procesin e socializimit të individit.<sup>15</sup>

Shkolla ka për detyrë të krijojë një klimë të ngrohtë e një mjedis tërheqës e edukues për të gjithë nxënësit, ku secilit t'i ofrohen shanse të barabarta për pjesëmarrje, aktivizim e përjetim të suksesit në punën mësimore dhe edukative gjatë gjithë periudhës së shkollimit. Mjedisi në klasë dhe në shkollë dhe klima sociale duhet të nxisë shprehjen e lirë të personalitetit të nxënësve, që është në proces formimi dhe konsolidimi. Një klimë e mirë në shkollë ndikon në arritjen e rezultateve të larta dhe të një shëndeti të mirë psiko-social. Ajo ndikon në rritjen e vetëvlerësimit, uljen e ankthit, parandalimin e stresit a depresionit të fëmijës dhe në mënjanimin e braktisjes së shkollës.<sup>16</sup>Një rol parësor në procesin e edukimit në shkollë luaj në edhe lëndët mësimore, ku fëmijët dhe të rinjtë fitojnë kompetenca për të respektuar vlerat dhe parimet demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri të hapur, demokratike dhe globale që

<sup>10</sup> Jashar Rexhepagiq, Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare, Prishtinë, 2005, faqe 36.

<sup>11</sup> Po aty, faqe 170.

<sup>12</sup> Gëzim Dibra, Fatmir Vadahi, Pedagogjia, Shtëpia Botuese "Camaj-Pipa", Shkodër, 1998, faqe 7.

<sup>13</sup> Po aty , faqe 7.

<sup>14</sup> Milika Dharmo etj. , Edukimi qytetar demokratik në Shqipëri, AEDP, Prill 1999, faqe 43.

<sup>15</sup> Po aty, faqe 43-44.

<sup>16</sup> Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës, Tiranë, 2011, faqe 48.



ndryshon me ritme të shpejta.

Për realizimin në vazhdimësi dhe me sukses të procesit të edukimit në grupmosha të ndryshme, rol të rëndësishëm kanë edhe metodat e edukimit. Duke u mbështetur në metodat edukative konjitiviste dhe në filozofinë biheviore, metodat e edukimit ndahen në dy grupe të mëdha:

- a) Metoda për formimin e vetëdijes
- b) metoda për formimin e sjelljes

Metodat për formimin e sjelljes janë : metoda e bindjes, metoda e kërkesës, metoda e të ushtruarit, metoda e nxitjes dhe e frenimit, metoda e imitimt dhe metoda e ndëshkimit.

Metoda e imitimt, krahas metodave të tjera të edukimit, është metodë specifike. Shpesh fëmijëve u ofrohet një model standard sjelljeje për imitim. Fëmijët mund të zgjedhin për imitim një model të mirë ose një model të gabuar. Kur është fjala për metodën e imitimt, si metodë edukimi, propozohet një model ose një shembull i denjë. Metoda e imitimt është një metodë e preferuar e teorive sociale mbi edukimin. Nga këto teori, imitimi shihet edhe me gjerë. Me të lidhen jo vetëm imitimet e sjelljeve të dikujt, si: të nënës, babait, mësuesit, shokut por edhe të faktit se sjellja e njeriut sinjalizon sjellje të ngjashme të një tjetri ose frenimin e sjelljeve të tjetrit.

Siç e theksuam edhe më lart, një model imitimi për fëmijët e vegjël është nëna. Shumë pedagogë e kanë vlerësuar rolin e nënës dhe të shëmbullit të saj për edukimin e fëmijëve. Edhe Naim Frashëri e ka nënvizuar rolin e shëmbullit në edukimin e fëmijëve. Një shembull i mirë i mëmës dhe i atësë, vlen më shumë se një mijë fjalë të mira të tyre, ka theksuar Naim Frashëri.

Personaliteti i shquar rus Suvorov, duke vlerësuar rolin

e shëmbullit në edukimin atdhetar, ka theksuar: "Merr si shembull një hero, ndiqe, arrije, kaloje dhe atëherë lavdi paç!"

Edhe professor Hamit Beqja i ka kushtuar rëndësi të veçantë fuqisë tërheqëse të shëmbullit në procesin e edukimit pa nënvleftësuar fuqinë e pazëvendësueshme edukative të fjalës.<sup>17</sup>

Modelet e edukimit merren kryesisht nga jeta, por edhe nga estetika dhe letërsia. Edukatori duhet të jetë elastik në punën e tij. Ai duhet t'ia përshtasë metodën e zgjedhur qëllimit të edukimit, ta përshtasë edhe me veçoritë individuale të personalitetit të të edukuarit.

Si përfundim, mund të themi se procesi i edukimit është një veprimtari e qëllimshme. Ai ka objektin dhe subjektin e tij. Ka synimin ose strategjitë, teknologjinë e edukatës dhe metodat e mjetet që përdoren. Shkolla ka për detyrë të krijojë një klimë të ngrohtë, të sigurt e miqësore për të gjithë nxënësit, ku secilit t'i krijohet mundësi për pjesëmarrje, aktivizim dhe përjetim të suksesit në punën mësimore dhe edukative gjatë gjithë kohës së shkollimit. Mjedisi dhe klima sociale duhet të nxisin shprehjen e lirë të personalitetit të nxënësve duke zhvilluar edhe mendimin kritik, aktiv e krijues gjatë procesit të mësimt dhe edukimit. Nxënësit janë një burim njerëzor me vlera shumë të mëdha që duhen edukuar në vazhdimësi. Ata janë të ndryshëm në shumë anë, por të gjithë të interesuar të jenë të aftë për jetën dhe të edukohen në kushte të barabarta. Vend parësor në procesin e edukimit zë edhe lufta kundër pirjes së alkoolit dhe duhanit, përdorimit të drogës dhe kundër çdo lloj dhune, brutaliteti a sjelljeje të rrezikshme, që janë probleme shqetësuese për brezin e ri në situatat që kalon shoqëria sot. Nxënësit, me orientimin e mësuesve, duhet të zbulojnë dhe sigurojnë informacione. Këto informacione duhet t'i përdorin për të reflektuar sjellje dhe qëndrime pozitive.

<sup>17</sup> Hamit Beqja, Kë edukojmë, si edukojmë? , Tiranë, 1987, faqe 267-268.

#### Literatura:

1. Shefik Osmani, Fjalori i pedagogjisë, Tiranë, 1983.
2. Hans Gehrig, Musa Kraja, Shefik Osmani. J. H. Pestaloci, Reformatori i madh i arsimit, Tiranë, 1997.
3. Milika Dhamo etj. , Edukimi qytetar demokratik në Shqipëri, AEDP, Prill 1999, faqe 43.
4. Hamit Beqja, Kë edukojmë, si edukojmë? , Tiranë, 1987.
5. Historia e letërsisë shqiptare, botim i Institutit të gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë, 1983.
6. Levis Vanghnn, Chris Mac Donald, Fuqia e mendimit kritik, CDE, Tiranë, 2010.
7. Inspektoriati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës, Tiranë, 2011.
8. Jashar Rexhepagiq, Sami Frashëri dhe pedagogjia e Rilindjes Kombëtare, Prishtinë, 2005.
9. Jean Piaget, IKS, Mbi pedagogjinë, Tiranë, 2005.
10. Gëzim Dibra, Fatmir Vadahi, Pedagogjia, Shkodër , 1998.
11. Musa Kraja, Pedagogjia, Tiranë , 2002.
12. Enciklopedia e përgjithshme, Tiranë, 2008.
13. Odisë Çaçi, Teoria dhe filozofia e edukimit, Vlorë, 2008.
14. Byroja Ndërkombëtare e Edukimit, UNESCO, Mendimtarë për edukimin, përkthehu Jonisa Angoni, Plejad, 2008.